

KOMUNIKATË MBËSHTETËSE PËR DEKLARATËN MBI ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE NË POLITIKË DHE JETËN PUBLIKE NË KOSOVË

Ne politikanet dhe politikanët, nëpunës civilë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të mbledhur në frymën e solidaritetit dhe qëllimit të përbashkët, përmes kësaj shprehim mbështetjen tonë të plotë për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë, të miratuar nga deputetët e partive të ndryshme politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës gjatë legjislaturës së VIII-të.

Duke e pranuar se dhuna ndaj grave në politikë dhe në jetën publike mbetet pengesë serioze dhe e vazhdueshme për qeverisjen përfshirëse dhe demokratike, dhe faktin se ajo cenon drejtpërdrejt pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në jetën politike, u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve përkatëse, në të gjitha nivelet e qeverisjes, që të ndërmarrin një qasje të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse për zbatimin kuptimplotë të dispozitave të kësaj Deklarate.

Me nënshkrimin e kësaj komunikate mbështetëse, ne rrisim zërin e Deklaratës së 19 nëntorit të vitit 2024 në komunat tona përkatëse, duke përforcuar kështu frontin e bashkuar që përfshin akterë të ndryshëm të shoqërisë, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.

IZJAVA PODRŠKE DEKLARACIJI O ELIMINACIJI SVIH OBLIKA NASILJA NAD ŽENAMA U POLITICI I JAVNOM ŽIVOTU NA KOSOVU

Mi, političarke i političari, javni službenici i službenice, kao i predstavnice i predstavnici građanskog društva, okupljeni u duhu solidarnosti i zajedničkog cilja, ovim putem izražavamo punu podršku Deklaraciji o eliminaciji svih oblika nasilja nad ženama u politici i javnom životu na Kosovu, koju su podržale i podržali poslanice i poslanici različitih političkih partija zastupljenih u Skupštini Kosova u okviru osmog saziva.

Uviđajući da nasilje nad ženama u politici i javnom životu i dalje predstavlja ozbiljnu i trajnu prepreku inkluzivnom i demokratskom upravljanju, kao i da direktno podriva puno i ravnopravno učešće žena u političkom životu, pozivamo sve relevantne institucije na svim nivoima vlasti da preduzmu delotvoran i sveobuhvatan pristup u cilju suštinske primene odredbi ove Deklaracije.

Potpisivanjem ove Izjave podrške, širimo glas Deklaracije od 19. novembra 2024. godine u našim opštinama, jačajući jedinstveni front koji obuhvata različite aktere u društvu sa ciljem okončanja nasilja nad ženama u politici i javnom životu.

				
				
				
				
				